



REPUBLIKË SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 267₁₄ Prot.

V E N D I M

Durrës më 24₁ / 2023

Nr. 45 Datë 24₁ / 2023

PËR

"MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË NË "SHKENCA EDUKIM", DIPLOMË E DYFISHTË ME UNIVERSITETIN E KRAKOW, POLONI DHE UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS, NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, PRANË DEPARTAMENTIT TË PEDAGOGJISË"

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë", Udhëzim Nr. 20 datë 30.09.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020", i ndryshuar, Udhëzim Nr.25, datë 28.12.2021 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "doktor" dhe të standardëve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "profesor i asociuar" dhe "profesor", ndryshuar me VKM Nr. 808, datë 11.12.2019, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Për miratimin e rregullores së programit të ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë në "Shkenca Edukimi", diplomë e dyfishtë me Universitetin e Krakow, Poloni dhe Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, në Fakultetin e Edukimit, pranë Departamentit të Pedagogjisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njësise Kryesore të Fakultetit
 - Drejtuesi i Njësise Bazë

N Ë N K R Y E T A R

Prof.AS.Dr.Renata TOKRRI

Adresa: Llogja Nr.1, Rr."Tallantia" Durrës, Tel: +355 52 39164, senat@unimoi.edu.al

